



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçante



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401291/3

Tiranë ___/___/2014

Lënda: Rekomandim për inspektimin e dosjes gjyqësore, në lidhje me gjykimin e kërkesës penale të kërkuarit V. Ç. nga Tirana, për zvarritje gjykimi.

Drejtuar : **Z. Sokol PASHO**
Drejtuar i Përgjithshëm Për Çështjet e Drejtësisë
Ministria e Drejtësisë.

TIRANË

Për dijeni : **Z. Petrit FUSHA**
Drejtues i Prokurorisë Rrethit Gjyqësor

Zj.Marsida XHAFERLLARI
K/Inspektore e KLD-së

TIRANË

I nderuar zoti Pasho,

Në ankesën e tij datë 02.07.2014 drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi V. Ç. nga Tirana ankohet ndaj Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, për zvarritje pa shkaqe ligjore të gjykimin të një kërkesë penale me objekt kundërshtim i vendimit mosfillimin të procedimit penal Nr.3624/2013 të Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në ankesën e tij shtetasi Vilson Çobani na sqaron se me datën 08.11.2013 i është drejtuar me kërkesë për gjykim Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila akoma nuk e ka përfunduar këtë gjykim duke zhvilluar disa seanca gjyqësore formale dhe pambarim. Duke analizuar shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore në këtë gjykim rezulton se shkak kryesor del se ka qënë mosparaqitja e prokurorit Dritan Nushi në gjykimin pa shkaqe ligjore.

Kryetari i seancës gjyqësore Z. Lazër Sallaku në seancën e datës 15.07.2014 ora 11.30' deklaroi se u thirr dhe nuk u paraqit prokurori Dritan Nushi i cili është njoftuar rregullisht me shkresën datë 02.07.2014 drejtuar Drejtuesit Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Tiranë, Z. Petrit Fusha duke e vënë në dijeni se seanca gjyqësore është shtyrë me datën 15.07.2014 sepse nuk është paraqitur prokurori i çështjes Dritan Nushi dhe kjo seance gjyqësore është caktuar me datën 15.07.2014 ora 11.30', duke sqaruar se në rast se ky prokuror nuk ka mundësi të paraqitet në gjykim nga ana e tij të caktohet një prokuror tjetër.

Kryetari i seancës gjyqësore vendosi të shtyjë seancën gjyqësore me datën 25.07.2014 ora 14.30' duke i dërguar përsëri shkresë drejtuesit

Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Tiranë Z. Petrit Fusha për marrjen e masave për të siguruar pjesëmarrjen e prokurorit në gjykim.

Nisur nga ky rast dhe konstatim në gjykojmë se ka vend për tu inspektuar dosja gjyqësore përkatëse nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, duke verifikuar seancat gjyqësore të zhvilluara nga data 08.11.2013 e deri më sot datë 15.07.2014 duke analizuar shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore dhe personat përgjegjës që janë shkaktar të shtyrjes së seancave gjyqësore në kundërshtim me kërkesat e ligjit material e procedural penal.

Në varësi të shkeljeve të konstatuara nga ana juaj të shikohet edhe mundësia e fillimit të procedimit disiplinor ndaj personit përgjegjës për rastin konkret.

Në nenin 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcaktohet se: "Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paaftë dhe e caktuar me ligj". Po kështu në rastin konkret ka vend të vepohet në përputhje me jurisprudencën e disa vendimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, dhe të Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë, ku deklarohet se: "**Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar**".

E drejta për tu gjykuar para një gjykate kompetente të pavarur dhe të paaftë dhe e caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm të bëhet por ajo të shihet se po bëhet.

Në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkeljen e të drejtave të njeriut, nga administrata publike", dhe duke u bazuar në kërkesat e nenit 25 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa apo njoftime për shkeljen e të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, vendimet e formës së prerë, dhe procedurat gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit.

Pë sa sipër, Ju

REKOMANDOJMË :

1. Të shikohet mundësia e inspektimit të dosjes gjyqësore, që ka lidhje me kërkesën e shtetasit Vilson Çobani me objekt kundërshtim të vendimit mbi mosfillimin e procedimit penal Nr.3624/2013 me gjyqtar z.Lazër Sallaku në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për zvarritje gjyqësore.

2. Mbi shkeljet e konstatuara dhe masat e marra nga ana juaj në bazë të kërkesave të nenit 22 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të njoftohemi me shkrim brenda 30 ditëve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI

